



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	20.01. 2020
REFERENC-Ë:	19/6007/2-806/DMMU
PËR/ZA/TO:	" Tihovci Com" Sh.p.k. Lebane, Prishtinë°
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 19/6007/2-806/DMMU, dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of
the General Secretary*

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 21 paragrafi 4 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ i kërkesës së " Tihovci Com" Sh.p.k. Lebane, Prishtinë , për Pëlqim Mjedisor, për bazën për prodhimin e betonit në Lebane, Prishtinë.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të " Tihovci Com" Sh.p.k. Lebane, Prishtinë , për Pëlqim Mjedisor, për bazën për prodhimin e betonit në Lebane, Prishtinë. , vlerëson si në vijim.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

- Pëlqimi i Komunës
- Kontrata për shfrytëzimin e ngastrave kur ngastra nuk është prone e kërkuarit për Pëlqim Mjedisor.

Dokumentacioni i kërkuar nuk është sjellur në bazë të kërkesës për plotësim dokumentacioni të datës 27.11.2019.

Faqe 2 nga 3

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju ka dërgua kërkesën më datë 27.11.2019, për **Plotësimin e dokumentacionit**, ku në bazë të nenit 21, paragrafët 2. dhe 3. të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214, është përcaktuar afati ligjor, të cilin afat nuk e keni respektuar për sjelljen e dokumentacionit të lartcekur.

Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ i kërkesës për Pëlqim Mjedisor me nr.prot.: 19/6338/2-845/DMMU, të kompanisë " Tihovci Com" Sh.p.k. Lebane, Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, për bazën për prodhimin e betonit në Lebane, Prishtinë.

Bazuar në mangësitë e dokumentacionit administrativ, si dhe në pamundësinë e marrjes së vendimit përfundimtar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/6007/2- ZSP/ 38 /20 datë:20.01.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm